



## **KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 7 mars 2011, në mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.10.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Habil Sylejmani, Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra rajonale në Prishtinë-Ekipi për komunitete dhe z. Martina Sokorova, LMT – KFOR.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri, me plotësim:

- Bashkëpunimi me OJQ Voi Sofroma

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 8 shkurt 2011**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### **3. Raport për vizitën e bërë komuniteteve pakicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e paraqiti fjalën e hyrjes.

**z. Jahë Lahu**, paraqiti raportin për vizitën e bërë më 28 shkurt 2011 pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkalinj në Podujevë lagja “ Xhafer Meta ”, i cili ndër të tjera njoftoi se janë vizituar dhe është konstatuar gjendja e familjeve si vijon:

Muharrem Behluli, i ka 9 anëtarë dhe jeton në gjendje të rëndë sociale me mungesa të shumta të gjërave elementare duke përfshirë edhe mungesën e artikujve ushqimor, kryefamiljari deklaroi se nuk ka kushte për shkollimin e fëmijëve.

Urim Behluli dhe Bashkim Behluli, jetojnë në familje prej 9 anëtarëve në kushte të vështira sociale.

Po ashtu familja e Rustem Behlulit, 12 anëtarë, jeton në kushte të vështira sociale dhe përballet me vështirësi për jetesë.

Familja e Bahtiar Miftarit, me 7 anëtarë dhe asnjë të punësuar ekzistencën e siguron nga ndihma sociale, mirëpo vështirësitë më të mëdha i ka ngase jeton në një shtëpi të materialit të dobët (material nga dheu-balta) e cila as afërisht nuk i plotëson kushtet minimale për strehim.

Nazmi Halili, me familje prej 14 anëtarëve jeton në kushte të vështira sociale ekzistencën e siguron nga ndihme sociale, gjatë vizitës anëtarët e moshës madhore kërkuan punësim por edhe çfarëdo ndihme momentale.

Shemsi Halili, me familje prej 6 anëtarëve, është shfrytëzues i ndihmës sociale, jeton në kushte të vështira, mirëpo problemi i tij më i madh çështja e strehimit ngase jeton në një shtëpi të materialit të dobët (material nga dheu-balta) e dëmtuar në të gjitha anët dhe si pasojë e kësaj janë të sëmurë nga të ftohtit.

Ramadan Sejdiu, me familje prej 7 anëtarëve, i pa punë, jeton nga ndihma sociale dhe nuk është në gjendje të siguroj kushtet elementare për jetesë.

Remzi Sejdiu, me familje prej 5 anëtarëve, jeton në kushte të vështira, pa ndihmë sociale dhe nuk ka kurrfarë të ardhurash, ndërsa ekzistencën e siguron me vështirësi vetëm me punë krahu të kohëpaskohshme.

Mursel Miftari, me familje prej 11 anëtarëve, shfrytëzues i ndihmës sociale, jeton në kushte shumë të vështira, ky kryefamiljar e ka një vajzë 6 vjeçare invalide.

Hysen Miftari, me familje prej 10 anëtarëve, është i papunë dhe jeton në kushte shumë të vështira sociale.

Raif Miftari, me familje prej 10 anëtarëve, gjithashtu jeton në kushte shumë të vështira sociale.

**z. Nebih Behluli**, u interesua të dijë se a janë përfitues të asistencës sociale kryefamiljarët të cilët u përfshinë në raportin e paraqitur dhe shtoi, lidhur me shkollimin jemi në dijeni se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i siguron librat ndërsa për veshmbathje mund të gjendet zgjidhje, kurse sa i përket zgjidhjes së çështjes së strehimit për dy familjet e cekura të shikohen mundësitë se a mund të ndërtohet ndonjë shtëpi përmes programit të Komunës për ndërtimin e shtëpive të karakterit social.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, parafolësit iu përgjigj se kryefamiljarët e përmendur janë përfitues të asistencës sociale, mirëpo brenga e tyre më e madhe është çështja e strehimit ngase jetojnë në shtëpi të ndërtuara nga materiali shumë i dobët dhe shtoi, për pjesëtarë të komunitetit rom dhe ashkalinj në vitin 2010 është ndërtuar një shtëpi e karakterit social ndërsa në vitin 2011 nuk është ndërtuar asnjë shtëpi.

**z. Burhan Blakçori**, theksoi, ndiejmë keqardhje për gjendjen e rëndë në veçanti sa i përket çështjes së strehimit të atyre dy familjeve dhe duhet bërë të gjitha përpjekjet për ofrimin e ndihmës së mundshme.

Gjithashtu duhet të shqyrtohet mundësia e sensibilizimit përmes mjeteve të informimit ngase shumë familje e kanë zgjidhë çështjen e strehimit nga donatorë të ndryshëm pas paraqitjes të gjendjes së tyre në RTV 21.

**z. Mefail Mustafa**, e përshëndeti nismën për vizita komunitetit rom dhe ashkalinj në mënyrë që drejtpërdrejt të merren informacionet e nevojshme dhe shtoi, sikur të

kisha qenë i informuar për datën e kësaj vizite me kënaqësi do t'i bashkëngjitesha grupit që ka dalë në terren.

**z. Nebih Behluli**, nënvizoi, në Komunën e Mitrovicës shumë familje të komunitetit rom dhe ashkalinj e kanë zgjidhë çështjen e strehimit në bazë të ndërtimit të objekteve për banim kolektiv, andaj duhet të hulumtohen mundësitë që në këtë mënyrë të bëhet zgjidhja e strehimit për disa familje të komuniteteve të cekura edhe në Komunën e Podujevës.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, u pajtua me parafolësin dhe shtoi edhe në Fushë Kosovë një donatorë i ka ndërtuar shumë shtëpi, ndërsa në Podujevë, përmes donacioneve, gjithsej janë ndërtuar dy apo tri shtëpi.

**z. Jahë Lahu**, theksoi, në Komunën e Podujevës për komunitetin rom dhe ashkalinj janë së paku gjashtë raste me prioritet për ndërtimin e shtëpive ngase ato familje jetojnë në kushte shumë të vështira.

**z. Habil Sylejmani**, u interesua të dijë se a ekziston ndonjë OJQ apo shoqatë tjetër e komunitetit rom dhe ashkalinj.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, parafolësit iu përgjigj, ka qenë OJQ "Shpresa Demokratike" mirëpo tash ajo shoqatë nuk funksionon.

**z. Mefail Mustafa**, theksoi, sipas raportit të paraqitur në lagjen Xhafer Meta janë tri familje me gjendje ekstreme sa i përket aspektit të strehimit, lidhur me këtë për rindërtimin e shtëpive duhet të sigurohen të dhëna ekzakte për familjet e cekura të cilat së pari do të trajtohen nga Drejtoria kompetente e pastaj të dërgohen nivelit qendror përkatësisht Kabinetit të Kryeministrit – Zyrës për komunitete dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim – Departamentit për komunitete.

Gjithashtu u shtrua edhe çështja e një fëmiju të sëmurë dhe u tha se këtë rast duhet ta trajtoj Drejtoria kompetente.

Pas votimit, njëzëri u miratua ky

## **Rekomandim**

I. I rekomandohet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të përgatit raportin me të dhënat relevante për gjendjen në aspektin e strehimit për familjet të cilat jetojnë në Podujevë, rr. "Xhafer Meta", si vijon:

1. Bahtiar Miftarin dhe
2. Shemsi Halilin

II. Në funksion të sensibilizimit të kësaj çështjeje, dalja në vendin e ngjarjes të bëhet në bashkëpunim me Zyrën e informimit.

III. Raporti i detajuar dhe i ilustruar me foto përkatëse t'i dërgohet këtij Komiteti për shqyrtim të mëtejshëm.

## **4. Bashkëpunimi me OJQ Voi Sofroma**

**z. Jahë Lahu**, foli për kontributin e dhënë në ofrimin e ndihmave nga Voi Sofroma me seli në Graçanicë dhe kërkesën gojore të kësaj OJQ-je që për bashkëpunimin e mëtejshëm të lidhë marrëveshje në formë të shkruar me këtë Komitet.

**z. Mefail Mustafa**, theksoi, në rastet kur një OJQ veprimtarinë e vetë e ushtron në lëmi të caktuara, po e zëmë në lëmin e arsimit, në rastet e këtilla duhet të njoftohet

edhe Drejtoria e Arsimit e cila do të ofrojë të dhënat e nevojshme por njëherit do të ofroj edhe këshilla profesionale.

**z. Nebih Behluli**, propozoi që kryesuesi i këtij Komiteti **z. Shaban Ahmeti**, të autorizohet për nënshkrimin e marrëveshjes së cekur.  
Propozimi i paraqitur u miratua njëzëri.

## **5. Të ndryshme**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi se disa anëtarë të këtij Komiteti, më 18 mars 2011, do të vizitojnë komunitetin rom dhe ashkalinj në rrugën “Ali Ajeti” në Podujevë.

**z. Jahë Lahu**, njoftoi se në shkollën fillore “Naim Frashëri”, nga komuniteti rom dhe ashkalinj, mësimet i vijojnë 100 nxënës, ndërsa në shkollën “Shaban Shala” 24 nxënës, ndërsa 5 nxënës i kanë braktisur mësimet prej të cilëve 2 në vitin paraprak shkollor ndërsa 3 prej tyre nuk vijojnë mësimet nga shtatori 2010.

Në shkollën e mesme mësimet i vijojnë gjithsej 20 nxënës.

**z. Radisav Peroviq**, theksoi, kohë më parë në lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergofc është mbajtur rituali fetar – Dita e të vdekurve, vizitorët kanë ardhur dhe vajtur pa kurrfarë problemi, pra kjo ka kaluar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe është për tu falënderuar.

**Mbledhja përfundoi në orën 11,55.**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01/48-06  
Podujevë,  
7 mars 2011**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**